

**VALBONA KALEMI**

**FRAZEOLOGJIA MBI BOTËN SHTAZORE NË KRAHINËN E  
KARDHIQIT (GJIROKASTËR)**

Krahina e Kardhiqit është një hapësirë ku ka klimë të favorshme për zhvillimin e blegtorisë. Kjo krahinë ka një larushi të madhe emërtimeve mbi gjallesat, përveç emërtimeve ajo njihet edhe për një pasuri të madhe të njësive frazeologjike që meritojnë të vlerësohen. Objekt i kësaj kumtese janë njësitë frazeologjike të krijuara për botën baritore kryesisht kafshët të cilat janë pjesë e pandashme e jetike në veprimtarinë njerëzore. Qëllimi i studimit synon të vendosë lidhjen përveç se me bashkësinë që i përdor edhe lidhjen e këtyre njësive me leksikonin e përgjithshëm të shqipes. E paraqes këtë vlerë të shtuar të kësaj krahine në gjuhësinë shqiptare me synimin për të mbledhur shumëçka nga gurra popullore, për aftësitë shënjuese që frazeologjia e saj ka. Studiuesi J. Thomai shprehet se “Gjithë frazeologjia shqipe, e përgjithshme e dialektore, e gjuhës së shkruar e të folur është vlerësuar si thesar i çmueshëm i krijuar brez pas brezi nga populli si një fond i pashtershëm për pasurimin e gjuhës letrare shqipe me njësi kuptimore dhe me mjete shprehëse”<sup>1</sup>. Krahina e Kardhiqit njihet për larushinë e emërtimeve, nëpërmjet tyre del në pah edhe mençuria popullore, karakteri historik e gjuhësor i veçantë i saj. Studiues të shumtë shqiptarë dhe kosovarë na kanë dhënë ndihmesë në studimet mbi leksikonin dialektor mbledhjen e frazeologjisë si dhe të dhëna mbi emërtimet e kafshëve dhe shpendëve në treva të veçanta që ia vlen ti përmendim si V. Memisha, J. Thomai, Gj. Shkurtaç, Z. Gjocaj etj. Emërtimet interesante, frazeologjia lidhur me to, të gjitha llojet e emërtimeve janë bërë një pasuri me vlerë në gjuhën shqipe një pasuri që sjell edhe zgjerimin e mjeteve të shprehjes në ligjërim sjell, vlera në përmbajtje e në ngjyrim emocional si dhe një gjykim popullor mjaft interesant.

**Fjalët çelës:** Njësi frazeologjike, bota shtazore, ligjërim popullor, ngjyrim emocional, mjete shprehëse.

Krahina e Kardhiqit (Gjirokastër) njihet për rritjen dhe zhvillimin e blegtorisë, përveç emërtimeve interesante për botën e kafshëve ajo është e pasur edhe me frazeologji e shprehje të urta popullore që janë të lidhura me të, gjë që e bën fjalësinë e banorëve më karakteristik në ligjërimin e përditshëm. Njeriu i përballur me natyrën qysh në lindjen e tij ai i ka njohur burimet natyrore, por edhe ka bërë vazhdimisht emërtime për to. Njeriu shpërfaq

---

<sup>1</sup> Shih J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, f. 199.

shprehësinë e shpirtin e bukur nëpërmjet njësisive frazeologjike, përmes tyre zbulojmë zakone, sjellje, kulturë ndërgjegje rreth botës shpirtërore të tij. Një vend të veçantë zë edhe emërtimi për botën shtazore dhe bimore duke shfaqur veten e tij ka realizuar një komunikim me individë të ndryshëm. Nëpërmjet emërtimeve të kafshëve janë koduar fjalë e njësi frazeologjike. Në komunikimin e përditshëm frazeologjia dhe shprehjet popullore zënë një vend të veçantë, janë pjesë e të shprehurit. Studiuesi Xh. Lloshi pohon “Frazeologjia i përket gjuhës së gjallë, ka më shumë ngarkesë emocionale e figurshme dhe pikërisht këto e dallojnë nga frazeologjia librore dhe kulturore, që në pjesën më të madhe është e kalkuar nga gjuhë të tjera. Shprehjet e figurshme të gjuhës shpesh përshkrime të gjalla domethënëse, të lidhura me fakte e shoqërimi emocionale, që kanë të bëjnë me historinë e popullit e të vendit, me jetën dhe kulturën e popullit”<sup>2</sup>. Emërtimi i botës shtazore pasqyron prirjen e gjuhës sonë për lindjen e tipave të rinj, por edhe të shprehjeve frazeologjike. Nëpërmjet larushisë së emërtimeve për botën shtazore dallojmë gjuhën mjeshtrërore të mjeshtrit popull në fjalësin e tij të përditshëm, nëpërmjet sintagmave emërore, mbiemërore etj. Sintagmat dhe njësitë frazeologjike që lidhen me botën shtazore vihen në shërbim të perceptimit psikologjik të individit të bashkësisë etnike, krahinore, kombëtare shqiptare. Nisur nga emërtimet që shprehin vetitë fizike e shëndetësore të kafshëve si: *shkathtësia, shpejtësia, lëvizshmëria, ngathtësia* përcillen vlerësime të ndryshme. Emërtimi i kafshëve sipas tipareve të jashtme në krahinën e Kardhiqit është mjaft interesant. Në këtë krahinë vihet në dukje jeta baritore e trashëguar, një traditë, një sjellje. Emërtimet sipas cilësisë intelektuale i veshin kafshët shtëpiake me statusin e qenieve njerëzore nëpërmjet sintagmave mbiemërore, foljore, si raste, *hipur në gomar*, shoqërore nëpërmjet veprimi praktikë emërtimeve të kafshëve vënë në dukje perceptimin psikologjik dhe sjellje shoqërore e gjuhësore. Perceptimi i banorëve të luginës së Kardhiqit në këto emërtime si dhe transmetime në një strukturë gjuhësore kanë ditur të tejkalojnë struktura logjike mbi gjallesat. Në paraqitjen e kafshëve shtëpiake si dhe emërtimet për to shprehet edhe një frazeologji ku pasqyrohet një traditë e një mendësi kulturore. Studiuesi V. Memishaj na ka paraqitur një pasqyrë të emërtimeve të kafshëve në zonën e Labërisë na ka dhënë një ndihmesë mjaft me interes<sup>3</sup>, për këtë kumtesë. Nga korpusi që ne kemi vjelë vërejmë:

a) emërtime që shprehin mungesën e intelektit si: *paaftësia, kokëfortësia, mendjelehtësia*.

b) emërtime që shprehin marrëzinë, injorancën si: *Dhi nga mendja, dhi e zgjebosur dhe bishti përpjetë*.

<sup>2</sup> Shih. Xh. Lloshi, *Stilistika dhe Pragmatika, Stilistikë e Përgjithshme*, Tiranë, 1999, f. 127.

<sup>3</sup> Shih. V. Memisha, *Emërtime për kafshë dhe shpendë në zonën e Labërisë*, Gjirokastër, 2001.

c) emërtime që shprehin një situatë, një sjellje shoqërore si: *ngul këmbë si mushka, ku të shpie mushka!, si cjapi te kasapi, vate për dhjamë qeni.*

Kombinimet e fjalëve kanë hyrë qysh herët në këtë ligjërim duke zënë një vend në ligjërimin e përditshëm të këtyre banorëve të kësaj treve si: *rrinte si sheleg përroi, erdhën me kuç e me maç, ashtu i do mushka drutë* (shtrembër), *i ka pjellë kokoshi, dridhet si krimi në dru, prit gomar të mijë bar*, në këto njësi të gatshme na del edhe karakteristika e kësaj të folmeje në veçoritë fonetike kryesisht. Pasuria që sjell dhe zgjerimi i mjeteve të shprehjes në ligjërim sjell vlera në përmbajtje e në ngjyrim emocionor. Prof. J. Thomai pohon se karakteri popullor i frazeologjisë së shqipes duket edhe në gjymtyrët përbërëse të njësive frazeologjike. Mjaft njësi ndeshen në fjalë që shënojnë bimë e kafshë (si *lule, lakër, ferrë, presh, qen, mushkë, pulë* etj.) me foljet e zakonshme (si: *bëj, kam hyj, dal, shkoj, shoh, vë, heq, kap* etj.<sup>4</sup>). Karakteri popullor i frazeologjisë duket edhe në njësitë përbërëse që shënojnë insekte *krimb, bletë*, etj. Brenda grupit gjejmë dhe gjendje shpirtërore, estetike që shprehin ironi. Tepria e përdorimeve varet edhe nga formimi kulturor i folësit, nga praktika e përditshme si dhe nga synimet e tij. Frazeologjia e përdorur në këtë krahinë për kafshë, shpendë është si vijon: **1. pula:** *u bëtë si shurrë e pulës* (pa lënë gjurmë një e nga një), *ktu ha dhe pula strall* (vend i thatë), *dolli si pula bashto, është bërë pulë, gjekët kakaris e gjekët bën venë* (vezën); **2. kokoshi:** *i ha qaurrat kokoshi* (i ngathët), *hidhet si kokosh pa bisht* (kot), *këtu këndon kokoshi*; **3. kal:** *gjezdis si kali në lëmë, i ka hipur kalit për së prapthi, si kalë karroce, kali i sertë s'ha shufër, kali vete vetë te grazhdi, kali nuk shitet me një të qorollisur*<sup>5</sup>; **4. gomari:** *gomarin mashkull e mrat* (mbrat), *prit gomar të mijë* (mbijë) *bar, shiu i beharit si vrap i gomarit, e ka lidhur gomarin, s'di t'i japë ujë gomarit*; **5. mushka:** *ku të shpie mushka, ashtu i do mushka drutë, mushkë e vënit* (vendit) *të nxjerr nga balta, një nga krushka një nga mushka, mos e harro mushkë Valarenë*; **6. krimb:** *kthenen si krimi në dru, është i krimur* (krimbur) *në para*; **7. qeni:** *të ha si qën fshehurazi* (i pabesë), *leh si qen, s'e ha as qeni, hante dhe qeni petulla, qen i hirës*; **8. maç:** *si maçi në thekër, erdhën me kuç e me maç, ka maçin në bark, shkon si maçja me minë*; **9. lopë:** *e lëshon si lopa bajgën, i ka pjellë lopa, është bërë si viç i pa lëpirë*; **10. derr:** *u bë derr, vate derr në thes, pëlçet derrin*; **11. dhi:** *dhi e xgjebosur e bishti përpyetë, dhi nga mëndja, bukuri dhe ment për dhi, ku di dhia ç'është tagjia*; **12. peshk:** *meti* (mbeti) *si peshku në zall, meti si peshku pa ujë*; **13. miza:** *si miza në qip, i djeg miza, se hanë as mizat, zë miza e u kren sitë, flet si miza në qip*; **14. dash:** *qethet me deshtë, vate si cjapi te kasapi*, **15. morr:** *iu bë morr* (i ngjitur); **16. bletë:** *u mlodhtin si bletë, si bletë e vulosur*;

<sup>4</sup> Shih. J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimi i tretë, Dudaj, 2005, f. 201.

<sup>5</sup> Këto të dhëna janë mbledhur nga banorët e krahinës së Kardhiqit dhe nga C. Shehu (fletore me kujtime) Cepunë (Gjirokastrë).

**17. kau:** *na ngordhi kau u prish* parmëna (parmënda); **18. zogu:** *si zogu i pazarit, i iku zogu nga duart*; **19. miza:** *ha miza, vret miza*; **20. bisha** (ujku): *mos u nda nga kopeja se të ha ujku, ka veshur lëkurën e ujkut, e vuri ujkun çoban*, **21. lepur:** *i ka hyrë lepurit në bark*; **22. cjan** (vajti) *si cjapi tek kasapi* (u gjend papritur). Përsa i përket ndërtimeve të kësaj frazeologjie kemi ndërtime me element krahasues me lidhëzën **si** dhe **sa**. Vërejmë se në të njëjtën strukturë ka në këtë krahinë edhe frazeologji mbiemërore sepse krahasohen cilësia e veprimeve dhe cilësia e sendeve si: *kalë pa fre, si pulë e lagur, nxjerr dhjam nga pleshti*. Këto përdorime janë të përdorura edhe më gjerësisht në folësit shqiptarë.

Grupi ndajfoljor tregon mënyrë.

*Si qeni në vësht, si kali qorr, si peshku në zall*, mënyra jepet nëpërmjet krahasimit si një gjymtyrë krahasuese është përdorimi i një frazeologjie krahasimi bëhet me sende e veprime të tipizuara megjithëse motivohen lehtë: (hahen) *si macja me minë, (vate) si brecka te nallbani*.

Brenda kësaj frazeologjie zbulojmë fusha konceptore si fusha që shprehet ironi. Njësitë e përdorura varen edhe nga formimi i folësit këto shpesh përdoren nga një numër banorësh që kanë edhe të jetuara, por edhe nga kulturimi i folësit dhe lloji i ligjërimeve ose me synime stilistike. Strukturat e formuara në këto frazeologji kanë edhe strukturë togfjalëshi dhe strukturë fjalie. Në frazeologjinë e grumbulluar është marrë në konsideratë edhe grupi paradigmatic i njësisive të motivuara nëpërmjet emërtimeve të kafshëve dhe bimëve si: *mu bë ferrë dukuritë* që zbulohen janë të rrafshit të përmbajtjes formës, dhe funksionit. Në format që janë të ndërtuara frazeologjitë që ne shqyrtojmë, vërejmë edhe përbërjen e tyre me mjete lidhëse kryesisht **si** dhe **sa** pra kemi ndërtime me elemente krahasuese me lidhëzën **si**: *si kali qorr, si peshku pa ujë, si peshku në zall, si këmët e dhisë, si brecka te nallbani*.

Kemi mbiemërorë frazeologjizmat: *si pulë e lagur, si kal i qorrollisur, dhi e xgjobosur*.

Grup ndajfoljor që tregojnë mënyrë në përgjithësi: *si qeni në vësht, si kal karroce, si peshku në zall*, Gjithashtu tek frazeologjia që paraqesim kemi ndërtime ku gjymtyra e dytë emër, mbiemër, luan kundrejt gjymtyrës së pare rol përcaktues, cilësues, e plotësues. Shkalla e cilësisë së veprimit tregohet në një shkallë të lartë, *si macja me minë, si frëngu pulën (naj shiti si frëngu pulën)*.

Ngarkesë emocionale të madhe kanë edhe frazeologjitë e ndërtuara me emra të bashkërenditur që i përkasin të njëjtës fushe leksikore si: *me qen e me mace, me kuç e me maç*. Përdorime të veçanta ka në këtë krahinë, por nga gjerësia gjeografike mund të themi se kemi mjaft përdorime edhe në krahinat e tjera si dhe në mbarë shqipen, me disa emërtime të veçanta kafshësh si dhe ndryshimet fonetike.

### **Përfundime**

#### Frazeologjia mbi botën shtazore në krahinën e Kardhiqit (Gjirokastër)

---

Nga materiali i mbledhur për botën shtazore vërejmë ndërtime dhe konstrukte të ndryshme por edhe nuancë të ndryshme kuptimesh. Ngarkesat emocionale që përcillen nëpërmjet gjësë së gjallë pasqyrojnë një botë të pasur të këtyre banorëve që kanë tipizuar veprime e vese nëpërmjet frazeologjisë. Materiali zbulon vlerën semantike funksionale të këtyre frazeologjizmave, por edhe veçantinë e lidhjes gjerësinë e fushës leksikore të fjalëve varianteve dhe formave, nuancë kuptimesh e përdorimesh. Frazeologjia ndajfoljore e kësaj ane nxjerr në pah vendin kohën, krahasimin, kanë gjithashtu një mbivlerë semantiko-ekspresive dhe stilistike. Në kuadër të mbledhjes së shumëçkaje, po mbledhim edhe frazeologjinë që u përket edhe fushave të tjera konceptore.

#### **BIBLIOGRAFI**

*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.

*Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, 2006.

V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.

Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, 2001.

